



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.143/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Podujevë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Podujevë, për shkak të vendosjes së posterit në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV), dega në Podujevë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Podujevë i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 1100 (njëmijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyetim

PZAP-i, me datën 04.06.2014, ka pranuar një ankesë, nga LVV, me të cilat pretendohet se me datën 04.06.2014 rreth orës 11:57, aktivistët e LVV-së kanë vërejtur se mbi rrugën “ Zahir Pajaziti” ishte vendosur poster i kandidatit Latif Gashi nga PDK. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë rast subjekti politik PDK ka bërë shkelje të nenit 4.1 pikës b të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013. Me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur një fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e informoi dhe urdhëroi që të ndërmarr masat përmirësuese lidhur me ankesat më datën 05.06.2014, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankese deri më datë 06.06.2014 në ora 10:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën deklaroi se aktivistët e PDK-së në Podujevë kanë ndërruar të gjitha masat përmisuese dhe kanë hëkur posterin e kandidatit për deputet Latif Gashi të vendosura në rrugën "Zahir Pajaziti" për të cilën është parashtruar ankesa brenda afatit të përcaktuar kohor. Përgjigjes në ankesë ia kanë bashkangjitur fotografitë me të cilën dëshmohet veprimi i largimit të posterave nga vendi që është bërë shkelja e pretenduar në ankesë .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesat janë të bazuara**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterin e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik PDK Latif Gashi janë të vendosur mbi rrugë publike, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë ndërtesave publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rëndësuese mori se subjekti politik PDK ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë posterin nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

Andaj PZAP-i duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik PDK është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri i kandidatit të tyre është vendosur mbi rrugë publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik PDK që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.143 /2014 më datën 06.06.2014.



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.